



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government**

***Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo za Životnu Sredinu, Prostorno Planiranje i Infrastrukturu
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure***

Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës,

Në mbështetje të nenit 24, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, (Gazeta Zyrtare Nr.14/2018 dt. 20.08.2018) i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-184 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje (Gazeta Zyrtare Nr.20/2023 dt. 16.08.2023) si dhe nenit 9 paragrafi 2 të Rregullores Nr. 17/2024 së Punës së Qeverisë.

Nxjerrë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV MMPHI-Nr.21/2024 PËR NDRYSHIMIN DHE
PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV MMPHI NR. 03/2021 PËR
KËRKESAT THEMELORE PËR SHËNDET DHE SIGURI, PROCEDURAT DHE
DOKUMENTACIONIN PËR TRAJTIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE TË
KATEGORISË I DHE II**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimit Administrativ MMPHI – Nr. 03/2021 për Kërkesat Themelore për Shëndet dhe Siguri, Procedurat dhe Dokumentacionin për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje të Kategorisë I dhe II.

Neni 2

1. Neni 1, i Udhëzimit Administrativ bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

Qëllimi i këtij Udhëzimit Administrativ është përcaktimi i kërkesave themelore të shëndetit dhe sigurisë, procedurave dhe dokumentacionit për trajtimin e ndërtimeve pa leje të kategorisë I dhe II të përfunduara, substancialisht të përfunduara apo të papërfunduara dhe ndërhyrjeve pa leje.

Neni 3

1. Neni 3, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, i Udhëzimit Administrativ bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

1.1. ndërhyrje pa leje në ndërtesën ekzistuese që e posedon certifikatën e përdorimit, lejen e përdorimit, apo një dokument tjetër ekuivalent, ose ndërtesën e regjistruar në Kadastër dhe në RDPP (më tutje “RDPP”), që nënkupton ndërhyrje pa leje në:

2. Neni 3, paragrafi 1.2, nën-paragrafi 1.2.1, i Udhëzimit Administrativ bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

1.2.1. ndryshim në numrin e kateve në krahasim me numrin e lejuar të kateve.

3. Neni 3, paragrafi 1.2, nën-paragrafi 1.2.2, i Udhëzimit Administrativ bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

1.2.2. ndryshim të shputës së ndërtesës në krahasim me shputën e lejuar; ose

Neni 4

1. Neni 5, paragrafi 13, i Udhëzimit Administrativ bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

13. Dispozitat e këtij neni dhe nenit 4 të Udhëzimit Administrativ bazë në lidhje me procedurën e aplikimit për certifikatë të legalizimit dhe shqyrtimin e aplikacionit nga ana e komunës zbatohen edhe për ndërhyrjet pa leje në ndërtimet e kategorisë I dhe shtëpitë e kategorisë II të përfunduara dhe substancialisht të përfunduara.

Neni 5

1. Nenin 8, paragrafi 11, i Udhëzimit Administrativ bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

11. Dispozitat e këtij neni, nenit 6 dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ bazë për procedurën e aplikimit për certifikatë të legalizimit, shqyrtimin e aplikacionit nga komuna si dhe kërkesat themelore për shëndet dhe siguri zbatohen edhe për ndërhyrjet pa leje në ndërtimet e kategorisë II të përfunduara dhe substancialisht të përfunduara të cilat nuk janë shtëpi.

2. Nenin 8, paragrafi 6, nën-paragrafi 6.2, i Udhëzimit Administrativ bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

6.2. Pas legalizimit të njësive në ndërtesën pa leje sipas nën-paragrafit 6.1 të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ bazë mund të regjistrojnë të drejtat pronësore të pronarëve të ndërtimit pa leje në RDPP pa kosto shtesë.

Neni 6

1. Neni 10, paragrafi 18, i Udhëzimit Administrativ bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

18. Dispozitat e këtij neni dhe nenit 9 të Udhëzimit Administrativ bazë, për procedurën e aplikimit për certifikatë të legalizimit dhe shqyrtimin e aplikacionit nga komuna si dhe zbatimin i kushteve ndërtimore sipas nenit 14 të Udhëzimit Administrativ bazë zbatohen edhe për ndërhyrjet pa leje në ndërtimet e kategorisë II të papërfunduara cilat nuk janë shtëpi.

Neni 7

1. Neni 13, paragrafi 15, i Udhëzimit Administrativ bazë, plotësohet dhe ndryshohet, me tekstin si në vijim:

15. Dispozitat e këtij neni dhe neneve 11 dhe 12 të Udhëzimit Administrativ bazë, për procedurën e aplikimit për certifikatë të legalizimit dhe shqyrtimin e aplikacionit nga komuna si dhe zbatimin i kushteve ndërtimore sipas nenit 14 të Udhëzimit Administrativ bazë, zbatohen edhe për ndërhyrjet pa leje në ndërtimet e kategorisë II të papërfunduara cilat nuk janë shtëpi.

Neni 8 **Shtojcat**

1. Pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi Administrativ janë:

1.1. Shtojca 1 - Formulari standard i aplikimit për certifikatë të legalizimit për kategorinë I dhe shtëpitë e kategorisë II;

1.2. Shtojca 1A - Formulari standard i aplikimit për leje të legalizimit për përfundim të ndërtimit për kategorinë I dhe shtëpitë e kategorisë II;

1.3. Shtojca 1B. - Deklaratë e pronarit të ndërtimit pa leje;

1.4. Shtojca 2 – Formulari standard i aplikimit për certifikatë të legalizimit për kategorinë II (jo shtëpitë) për ndërtimet e përfunduara ose substancialisht të përfunduara;

1.5. Shtojca 2A - Formulari standard i aplikimit për leje të legalizimit për përfundim të ndërtimit për kategorinë II (jo shtëpitë)

1.6. Shtojca 3 - Formulari standard i aplikimit për lirim nga taksat për legalizimin e ndërtimit pa leje;

1.7. Shtojca 4 – Shqyrtimi i aplikacioneve për të gjitha kategoritë;

1.8. Shtojca 5 – Inspektimi i kërkesave themelore për shëndet dhe siguri për ndërtimet pa leje për ndërtimet në kategorinë II (jo shtëpitë);

1.9. Shtojca 6 – Njoftim Publik;

1.10. Shtojca 7a – Lista kontrolluese për shqyrtim të projektit ideor për përfundim të ndërtimit, ndërtimet e kategorisë I dhe shtëpitë e kategorisë II (mbi 450m²);

1.11. Shtojca 7b - Lista kontrolluese për shqyrtim të projektit kryesor për përfundim të ndërtimit për ndërtimet në kategorinë II (jo shtëpitë)

1.12. Shtojca 8 – Njoftimi për taksat dhe tarifat;

1.13. Shtojca 9 – Leja e legalizimit për përfundim të ndërtimit;

1.14. Shtojca 10 – Vendimi për Certifikatën e Legalizimit;

1.15. Shtojca 11 - Vendimi për përfshirje në listë të pritjes.

Neni 9 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ shfuqizohen Shtojcat 1 deri në 11 të Udhëzimit Administrativ MMPHI – Nr. 03/2021 për Kërkesat Themelore për Shëndet dhe Siguri, Procedurat dhe Dokumentacionin për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje të Kategorisë I dhe II.

Neni 10 Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Liburn Aliu

Ministër i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Data: 26.12.2024

Shtojca 1 - Formulari standard i aplikimit për certifikatë të legalizimit për kategorinë I dhe shtëpitë e kategorisë II



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna / Opština / Municipality

Llogo e
Komunës

Për plotësim në zyrë (nga Komuna)	
Numri i Referencës:	
Data e pranimit:	

Kategorizimi i ndërtimeve behet sipas Udhëzimit Administrativ të MMPH, nr. 04/2017 për Kategorizimin e Ndërtimeve, shtojcat 1 dhe 2

1. Informatat rreth Aplikuesit		A është aplikuesi i autorizuar? Jo ☐ Po ☐ Nëse po, aplikimit i bashkëngjitet marrëveshja e noterizuar me pronarin e ndërtimit pa leje	
Emri:		Nr. i ID:	
Adresa:			
Telefoni:		☐	Kontakti përmes telefonit apo përmes e-mailit?
E-maili:		☐	

2. Informatat rreth pronarit të ndërtimit			
Emri:		Nr. i ID:	
Adresa:			

2a. Kopja e letërnjoftimit të aplikuesit	Po	Jo
	☐	☐

3A. Dëshmitë se aplikuesi është përfitues i skemës së ndihmës sociale në Kosovë janë bashkangjitur	Po	Jo
	☐	☐

Dokumentet në pikën 7 dorëzohen në tri (3) kopje fizike dhe një (1) kopje digjitale - pjesët grafike në format PDF dhe DWG.

4. Dëshmitë mbi ndërtimin e kryer para datës 05.09.2018:	Po	Jo	N/Aⁱ
a. Ortofoto zyrtare ose fotografi tjera ajrore apo satelitore të realizuara para datës 05.09.2018, në të cilën shihet ndërtimi.	☐	☐	☐
Nëse ekzistimi i ndërtimit nuk mund të vërtetohet sipas pikës a, aplikuesi jep një deklaratë nën betim lidhur me kohën kur është ndërtuar ndërtimi (pika b.), si dhe një nga dëshmitë të listuara nën pikat c, d, ose e.			
b. Deklaratë nën betim lidhur me kohën kur është ndërtuar ndërtimi	☐	☐	☐
c. Prova të pagesës së tatimit në pronë	☐	☐	☐
d. Prova të pagesës së faturave të shërbimeve publike	☐	☐	☐
e. dokument të lëshuar nga një autoritet publik	☐	☐	☐
Në rast të mungesës së dëshmimeve nën pikat c, d, ose e, aplikuesi sjellë dy nga dëshmitë nën pikat f, g, h, i.			
f. fatura të ndërlidhura për ndërtimin	☐	☐	☐
g. kontratë të ndërlidhur për ndërtimin	☐	☐	☐
h. deklaratë nën betim të një dëshmitari që nuk është i lidhur me aplikuesin, pronarin e ndërtimit pa leje ose investitorin	☐	☐	☐
i. dokument tjetër të besueshëm që dëshmon kohën kur është ndërtuar ndërtimi	☐	☐	☐

5. Dëshmitë mbi të drejtën pronësore ose të drejtën e shfrytëzimit mbi parcelën:	Po	Jo	N/A
Kopja e planit dhe certifikata e pronësisë jo më të vjetra se gjashtë muaj. Nëse pronari i ndërtimit pa leje nuk është pronari i regjistruar i parcelës, dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm për të dëshmuar të drejtën pronësore ose të drejtën e shfrytëzimit mbi parcelën.	☐	☐	☐

6. Profesionisti që bën matjen/incizimin e ndërtimit ekzistues pa leje			
Gjeodet i licencuar		Telefoni:	Emaili:

7. Matja / incizimi i ndërtimit ekzistues pa leje	Po	Jo	N/A
a. Matjet gjeodezike sipas Kornizës së Punës për matje, krijim dhe regjistrim të njësive kadastrale, të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, në lidhje me trajtimin e ndërtimeve pa leje. Vërejtje: të ndërhyrjet pa leje në ndërtimet me leje, incizimi bëhet për pjesën e ndërhyrjes	☐	☐	☐
b. Fotografitë që prezantojnë dukjet e ndërtimit pa leje (të gjitha fasadat) Vërejtje: Te ndërhyrjet, fotografitë duhet të prezantojnë ndërtesën dhe ndërhyrjen pa leje (të gjitha fasadat), si dhe ndërhyrjen pa leje si të veçantë (të gjitha fasadat)	☐	☐	☐

8. Deklarata e pronarit të ndërtimit pa leje (shtojca 1B)	Po	Jo
	☐	☐

9. Deklarata e aplikuesit	
Aplikoj për certifikatën e legalizimit të ndërtimit, sipas përshkrimeve në këtë formular dhe në dokumentet përcjellëse, prezentimet grafike dhe informatat shtesë. Konfirmoj se të gjitha faktet të deklaruara në këtë aplikacion janë të vërteta dhe të sakta.	
Nënshkrimi i aplikuesit:	Data (DD/MM/VVVV):
Nënshkrimi i Zyrtarit kompetent:	Data (DD/MM/VVVV):
Vërejtje: Para aplikimit për legalizim duhet të lexohet Ligji Nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe ky Udhëzim Administrativ për tu informua për dokumentet e nevojshme për aplikim, apo të kërkoj sqarime në Komunë. *** Ju lutemi kërkon nga Zyrtari/ja fletë-dëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura ***	

Shtojca 1A - Formulari standard i aplikimit për leje të legalizimit për përfundim të ndërtimit për kategorinë I dhe shtëpitë e kategorisë II

Republika e Kosovës



Republika Kosova – Republic of Kosova

Komuna / Opština / Municipality

Llogo e
Komunës

Kategorizimi i ndërtimeve bëhet sipas Udhëzimit Administrativ të
MMPH, nr. 04/2017 për Kategorizimin e Ndërtimeve, shtojcat 1 dhe 2.

Për plotësim në zyrë (nga Komuna)	
Numri i Referencës:	
Data e pranimit:	

Vërejtje: Kategorizimi i ndërtimeve të papërfunduara pa leje bëhet në bazë të sipërfaqes dhe veçorive tjera ekzistuese dhe atyre të planifikuara për përfundimin e ndërtimit

1. Informatat rreth Aplikuesit		A është aplikuesi i autorizuar? Jo ☐ Po ☐	
		Nëse po, aplikimit i bashkëngjitet marrëveshja e noterizuar me pronarin e ndërtimit pa leje	
Emri:		Nr. i ID:	
Adresa:			
Telefoni:		☐	Kontakti përmes telefonit apo përmes e-mailit?
E-maili:		☐	

2. Informatat rreth pronarit të ndërtimit			
Emri:		Nr. i ID:	
Adresa:			

2A. Kopja e letërnjoftimit të aplikuesit	Po	Jo
	☐	☐

3. Detajet rreth ndërtimit ekzistues të papërfunduar			
Adresa e ndërtimit (ose përshkrimi i lokacionit):			
Zona Kadastrale:		Nr. i Parcelës	
Koordinatat e vendndodhjes GPS:			
Funksioni: Shtëpi ☐ Garazh në shërbim të shtëpisë ☐ Objekt bujqësor (deri 600m2) ☐			
Shtëpi me afarizëm/komerciale (banim mbi 50%) ☐ Depo ku nuk deponohen mat. të rrezikshme (deri 1500m2) ☐			
Viti i ndërtimit			
Plotësoni nën A, ose nën B, ose nën C			
A) Ndërtim pa leje ndërtimore Sipërfaqja bruto e ndërtimit: _____ m ² Numri i kateve të ndërtimit: _____	B) Ndërtim në kundërshtim me lejen ndërtimore: Ndryshim në numrin e kateve në krahasim me numrin e lejuar të kateve Ndërtimin e më shumë kateve se që janë lejuar me sipas lejes së ndërtimit ☐ <u>Ndryshim të shputës së ndërtesës në krahasim me shputën e lejuar sipas lejes së ndërtimit</u> ☐ Ndryshim në brendi dhe/apo ndryshim i përdorimit/destinimit në raport me specifikimet e dhëna në leje të ndërtimit ☐ Tjetër: _____ Sipërfaqja bruto e tërë ndërtimit: _____ m ²	C) Ndërhyrje pa leje: Mbindërtim ☐ Zgjerim ☐ Ndërhyrje pa leje në brendi të ndërtesës dhe/apo ndryshim pa leje i përdorimit/destinimit ☐ Sipërfaqja bruto ndërhyrjes: _____ m ² Numri i kateve të ndërhyrjes: _____	

3A. Dëshmitë se aplikuesi është përfitues i skemës së ndihmës sociale në Kosovë janë bashkangjitur	Po	Jo
	☐	☐

Dokumentet në vijim, përveç pikës 8, dorëzohen në një (1) original dhe dy (2) kopje.

Dokumentet në pikën 8 dorëzohen në tri (3) kopje fizike dhe një (1) kopje digjitale - pjesët grafike në format PDF dhe DWG.

4. Dëshmitë mbi ndërtimin e kryer para datës 05.09.2018:	Po	Jo	N/A ⁱ
a. Ortofoto zyrtare ose fotografi tjera ajrore apo satelitore të realizuara para datës 05.09.2018, në të cilën shihet ndërtimi.	☐	☐	☐

Nëse ekzistimi i ndërtimit nuk mund të vërtetohet sipas pikës a, aplikuesi jep një deklaratë nën betim lidhur me kohën kur është ndërtuar ndërtimi (pika b.), si dhe një nga dëshmitë të listuara nën pikat c, d, ose e.			
b. Deklaratë nën betim lidhur me kohën kur është ndërtuar ndërtimi	☐	☐	☐
c. Prova të pagesës së tatimit në pronë	☐	☐	☐
d. Prova të pagesës së faturave të shërbimeve publike	☐	☐	☐
e. dokument të lëshuar nga një autoritet publik	☐	☐	☐
Në rast të mungesës së dëshmimeve nën pikat c, d, ose e, aplikuesi sjellë dy nga dëshmitë nën pikat f, g, h, i.			
f. fatura të ndërlidhura për ndërtimin	☐	☐	☐
g. kontratë të ndërlidhur për ndërtimin	☐	☐	☐
h. deklaratë nën betim të një dëshmitari që nuk është i lidhur me aplikuesin, pronarin e ndërtimit pa leje ose investitorin	☐	☐	☐
i. dokument tjetër të besueshëm që dëshmon kohën kur është ndërtuar ndërtimi	☐	☐	☐

5. Dëshmitë mbi të drejtën pronësore ose të drejtën e shfrytëzimit mbi parcelën:	Po	Jo	N/Aⁱ
Kopja e planit dhe certifikata e pronësisë jo më të vjetra se gjashtë muaj. Nëse pronari i ndërtimit pa leje nuk është pronari i regjistruar i parcelës, dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm për të dëshmuar të drejtën pronësore ose të drejtën e shfrytëzimit mbi parcelën.	☐	☐	☐

6. Punët e planifikuara ndërtimore	Po	Jo
Për përfundimin e ndërtimit parashihen punë ndërtimore shtesë që ndërrojnë shputën ose lartësinë e ndërtimit, ose e ndryshojnë destinimin ekzistues Nëse keni zgjedhur opsionin “PO”, në vijim i plotësoni tabelat: 7, 8, 10 dhe 12. Nëse keni zgjedhur opsionin “JO”, në vijim i plotësoni tabelat: 7 (b, d), 8 (a, b), 9, 11 dhe 12.	☐	☐

7. Dokumentacioni i profesionisteve që përgatisin <u>matjen / incizimin te gjendjes ekzistuese të ndërtimit pa leje të papërfunduar</u>		Po	Jo
Ekipi hartues i projektit të gjendjes ekzistuese			
a. Inxhinier i ndërtimtarisë <u>(Aplikohet nëse në TABELËN 6 përgjigja është “PO”)</u>		Telefoni:	Emaili:
b. Gjeodeti i licencuar		Telefoni:	Emaili:

c. Deklaratë e ekipit të matjes/incizimit <u>(Aplikohet nëse në TABELËN 6 përgjigja është “PO”)</u>	☐	☐
d. Diplomat e ekipit të matjes/incizimit	☐	☐

8. Matja / incizimi i gjendjes ekzistuese të ndërtimit pa leje të papërfunduar	Po	Jo	N/A
a. Matjet gjeodezike sipas Kornizës së Punës për matje, krijim dhe regjistrim të njësive kadastrale, të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, në lidhje me trajtimin e ndërtimeve pa leje. Vërejtje: të ndërhyrjet pa leje në ndërtimet me leje, incizimi bëhet për pjesën e ndërhyrjes	☐	☐	☐
b. Fotografitë që prezantojnë dukjet e ndërtimit pa leje (të gjitha fasadat) Vërejtje: Të ndërhyrjet, fotografitë duhet të prezantojnë ndërtesën dhe ndërhyrjen pa leje, si dhe ndërhyrjen pa leje si të veçantë	☐	☐	☐
c. Raporti i profesionistit për stabilitetin e strukturës duke përfshirë përfundimin për sigurinë dhe stabilitetin e ndërtimit; (të ndërhyrjet pa leje të jepet raporti mbi strukturën e ndërhyrjes pa leje dhe ndikimet në strukturën e ndërtimit me leje) <u>(Aplikohet nëse në TABELËN 6 përgjigja është “PO”)</u>	☐	☐	☐
d. Fotografitë e ndërtesave fqinje në zonën prej së paku pesëdhjetë (50) metrash nga vijat kufizuese të parcelës kadastrale ku aplikuesi propozon të përfundojë ndërtimin <u>(Aplikohet nëse në TABELËN 6 përgjigja është “PO”)</u>	☐	☐	☐

9. Deklarata e pronarit të ndërtimit pa leje (shtojca 1B)	Po	Jo
<u>(Aplikohet nëse në TABELËN 6 përgjigja është “JO”)</u>	☐	☐

10. Propozimi i kushteve ndërtimore për përfundimin e ndërtimit të papërfunduar pa leje <u>(Aplikohet nëse në TABELËN 6 përgjigja është “PO”)</u>
Përshkrimi i mjedisit rrethues dhe ndërtesave

Ju lutem përshkruani ndërtimet ekzistuese dhe karakteristikat e rrethinës përbrenda pesëdhjetë (50) metrash nga vijat kufizuese të parcelës kadastrale ku aplikuesi propozon të përfundojë ndërtimin pa leje të papërfunduar:

a. A ekzistojnë ndërtime ne rrethinë përbrenda pesëdhjetë (50) metrash nga vijat kufizuese të parcelës tuaj:

PO **JO** , Nëse **PO**, Cila Kategori e **I** **II** **III**

b. Përshkruani ndërtimet ne rrethinë përbrenda pesëdhjetë (50) metrash nga vijat kufizuese të parcelës tuaj:

Kushtet e propozuara ndërtimore

a. **Destinimi i propozuar i shfrytëzimit të tokës:**

a.1. **Përdorimi i propozuar i ndërtesës**

b. Vija rregulluese (VRR) nga skaji i rrugës publike.

m'

c. Vija e ndërtimit (VN) nga kufijtë e parcelës kadastrale kah:

c.1. Pjesa ballore kah rruga publike

m'

c.2. Anët – djathtas (AD)

m'

c.3. Anët – majtas (AM)

m'

c.4. Pasmë

m'

d. Lartësia e lejuar në raport me largësinë nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike

/

e. Lartësia e lejuar në raport me largësinë nga kufiri anësor (anësor djathtas ndërtimit AD dhe anësor majtas AM) dhe i pasmë (P) të parcelës kadastrale

P /
AD /
AM /

f. Përqindja e sipërfaqes të përgjithshme shfrytëzueshme për shputën e ndërtesës kadastrale

(Indeksi i Shfrytëzimit të Parcelës Kadastrale për Zhvillim - ISHPKZh)

%

g. Përqindja e sipërfaqes së përgjithshme e gjelbërimit për absorbim të reshjeve atmosferike në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale

(Sipërfaqja absorbuese gjelbëruese e parcelës SAGJP)

%

h. Përqindja e sipërfaqes së përgjithshme e ndërtimit brenda parcelës kadastrale në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale

(Indeksi i Sipërfaqes së Ndërtuar - ISN)

i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale

Sipërfaqja nëntokësore e parcelës (SNP)

%

j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve

k. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtimit:

l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po ☐ Jo ☐ Nuk aplikohet ☐

Sqaro:

m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe se sa zona përreth? Po ☐ Jo ☐ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po ☐ Jo ☐ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:
o. Tjetër:
Projekti Konceptual për përfundimin e ndërtimit të papërfunduar pa leje Po ☐ Jo ☐

11. Punët ndërtimore për përfundimin e ndërtimit <u>(Aplikohet nëse në TABELËN 6 përgjigja është “JO”)</u>	
Instalimi i sistemit të ujës-jellësit ☐	Hidroizolimi ☐
Instalimi i sistemit të kanalizimit ☐	Fasadimi ☐
Instalimi i sist. të furnizimit me energji elektrike ☐	Mbulesa e pullazit ☐
Instalimi i sistemit të ngrohjes ☐	Zdrukhëtaria e jashtme ☐
Izolimi termik ☐	Punët e finalizimit të enterierit ☐
Punë tjera për finalizim (përshkruaj) _____ _____	

12. Deklarata e aplikuesit	
Unë aplikoj për lejen e legalizimit për përfundim të ndërtimit, sipas përshkrimeve në këtë formular dhe në dokumentet përcjellëse, prezentimet grafike dhe informatat shtesë. Konfirmoj se sipas dijenisë sime më të mirë të gjitha faktet të deklaruara në këtë aplikacion janë të vërteta dhe të sakta.	
Nëse për përfundimin e ndërtimit parashihen punë ndërtimore shtesë që ndërrojnë shputën ose lartësinë e ndërtimit, ose e ndryshojnë destinimin ekzistues, jam i njoftuar se ky aplikim konsiderohet i kompletuar vetëm pasi që ta dorëzoj edhe projektin ideor për përfundimin e ndërtimit , sipas kushteve ndërtimore të miratuara nga Organi Kompetent	
Nënshkrimi i aplikuesit:	Data (DD/MM/VVVV):
Nënshkrimi i Zyrtarit kompetent:	Data (DD/MM/VVVV):
(pranimi i dokumenteve të aplikacionit para dorëzimit të	
Nënshkrimi i Zyrtarit kompetent pas kompletimit të aplikacionit:	Data (DD/MM/VVVV):

Vërejtje: Para aplikimit për legalizim duhet të lexohet Ligji Nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe ky Udhëzim Administrativ për tu informua për dokumentet e nevojshme për aplikim, apo të kërkoj sqarime në Komunë. *** Ju lutemi kërkon nga Zyrtari/ja fletë-dëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura ***	

DEKLARATË E PRONARIT TË NDËRTIMIT PA LEJE

Për ndërtimet e kategorisë I dhe shtëpitë e kategorisë II (mbi 450m²)

Si pronar i ndërtimit pa leje për të cilin dorëzova aplikacionin për certifikatë legalizimi, apo aplikacionin për leje legalizimi për përfundim të ndërtimit (pa zgjerim të shputës, rritjes së lartësisë apo ndryshim të destinimit), i pranoj të gjitha përgjegjësitë për sigurinë e strukturës së këtij ndërtimi.

Jam i vetëdijshëm se organi kompetent nuk do të bëjë inspektim të ndërtimit për qëllimet e shqyrtimit të këtij aplikimi, dhe se me lëshimin e certifikatës së legalizimit organi kompetent nuk merr përgjegjësi për sigurinë e strukturës së këtij ndërtimi.

Jam i vetëdijshëm se kjo deklaratë do të shënohet në certifikatën e legalizimit dhe do të regjistrohet në kadastër, dhe se si pronar i këtij ndërtimi pa leje jam i obliguar që për këtë deklaratë ti informoj të gjithë shfrytëzuesit aktual apo të ardhshëm të këtij ndërtimi, zotëruesit aktual apo të ardhshëm të të drejtave sendore mbi këtë ndërtim, si dhe çfarëdo pale të interesuar për blerjen e këtij ndërtimi, apo të ndonjë pjese të tij në të ardhmen.

Vendi dhe data: _____

Nënshkrimi i pronarit të ndërtimit pa leje

Nënshkrimi i zyrtarit kompetent që e pranon këtë deklaratë

Shtojca 2 - Formulari standard i aplikimit për certifikatë të legalizimit për kategorinë II (jo shtëpitë) për ndërtimet e përfunduara ose substancialisht të përfunduara



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosova

Llogo e
Komunës

Komuna / Opština / Municipality

Për plotësim në zyrë (nga Komuna)	
Numri i Referencës:	
Data e pranimit:	

Kategorizimi i ndërtimeve behet sipas Udhëzimit Administrativ të MMPH, nr. 04/2017 për Kategorizimin e Ndërtimeve, shtojcat 1 dhe 2

2. Informatat rreth Aplikuesit		A është aplikuesi i autorizuar? Jo ☐ Po ☐	
		Nëse po, aplikimit i bashkëngjitet marrëveshja e noterizuar me pronarin e ndërtimit pa leje	
Emri:		Nr. i ID:	
Adresa:			
Telefoni:		☐	Kontakti përmes telefonit apo përmes e-mailit?
E-maili:		☐	

2. Informatat rreth pronarit të ndërtimit			
Emri:		Nr. i ID:	
Adresa:			

2a. Kopja e letërnjoftimit të aplikuesit	Po	Jo
	☐	☐

3. Detajet rreth ndërtimit			
Adresa e ndërtimit (ose përshkrimi i lokacionit):			
Zona Kadastrale:		Nr. i Parcelës Kadastrale:	
Koordinatat e vendndodhjes GPS:			
Funksioni: Banim me shumë njësi ☐ Konvikte apo ngjashëm ☐ Hotele apo ngjashëm ☐ Afarizëm dhe administratë ☐ Industri, depo ☐ Art, kulturë, argëtim ☐ Arsime, shkencë ☐ Shëndetësi ☐ Sport, rekreacion ☐ Bujqësi ☐ Tjetër: _____			
Viti i ndërtimit			
Plotësoni nën A, ose nën B, ose nën C			
A) Ndërtim pa leje ndërtimore Sipërfaqja bruto e ndërtimit: _____ m ² Numri i kateve të ndërtimit: _____		B) Ndërtim në kundërshtim me lejen ndërtimore: <u>Ndryshim në numrin e kateve në krahasim me numrin e lejuar të kateve sipas lejes së ndërtimit</u> ☐ <u>Ndryshim të shputës së ndërtesës në krahasim me shputën e lejuar sipas lejes së ndërtimit</u> ☐ Ndryshim në brendi dhe/apo ndryshim i përdorimit/destinimit në raport me specifikimet e dhëna në leje të ndërtimit ☐ Tjetër: _____ Sipërfaqja bruto e tërë ndërtimit: _____ m ² Numri i të gjitha kateve të ndërtimit: _____	
		C) Ndërhyrje pa leje: Mbindërtim ☐ Zgjerim ☐ Ndërhyrje pa leje në brendi të ndërtesës dhe/apo ndryshim pa leje i përdorimit/destinimit ☐ Sipërfaqja bruto ndërhyrjes: _____ m ² Numri i kateve të ndërhyrjes: _____	

3A. Dëshmitë se aplikuesi është përfitues i skemës së ndihmës sociale në Kosovë janë bashkangjitur	Po	Jo
	☐	☐

Dokumentet në vijim, përveç pikës 7, dorëzohen në një (1) origjinal dhe dy (2) kopje.

Dokumentet në pikën 7 dorëzohen në tri (3) kopje fizike dhe një (1) kopje digjitale - pjesët grafike në format PDF dhe DWG.

4. Dëshmitë mbi ndërtimin e kryer para datës 05.09.2018:	Po	Jo	N/Aⁱ
a. Ortofoto zyrtare ose fotografi tjera ajrore apo satelitore të realizuara para datës 05.09.2018, në të cilën shihet ndërtimi.	☐	☐	☐
Nëse ekzistimi i ndërtimit nuk mund të vërtetohet sipas pikës a, aplikuesi jep një deklaratë nën betim lidhur me kohën kur është ndërtuar ndërtimi (pika b.), si dhe një nga dëshmitë të listuara nën pikat c, d, ose e.			
b. Deklaratë nën betim lidhur me kohën kur është ndërtuar ndërtimi	☐	☐	☐
c. Prova të pagesës së tatimit në pronë	☐	☐	☐
d. Prova të pagesës së faturave të shërbimeve publike	☐	☐	☐
e. dokument të lëshuar nga një autoritet publik	☐	☐	☐
Në rast të mungesës së dëshmive nën pikat c, d, ose e, aplikuesi sjellë dy nga dëshmitë nën pikat f, g, h, i.			
f. fatura të ndërlidhura për ndërtimin	☐	☐	☐
g. kontratë të ndërlidhura për ndërtimin	☐	☐	☐
h. deklaratë nën betim të një dëshmitari që nuk është i lidhur me aplikuesin, pronarin e ndërtimit pa leje ose investitorin	☐	☐	☐
i. dokument tjetër të besueshëm që dëshmon kohën kur është ndërtuar ndërtimi	☐	☐	☐

5. Dëshmitë mbi të drejtën pronësore ose të drejtën e shfrytëzimit mbi parcelën:	Po	Jo	N/Aⁱ
Kopja e planit dhe certifikata e pronësisë jo më të vjetra se gjashtë muaj. Nëse pronari i ndërtimit pa leje nuk është pronari i regjistruar i parcelës, dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm për të dëshmuar të drejtën pronësore ose të drejtën e shfrytëzimit mbi parcelën.	☐	☐	☐

6. Dokumentacioni i kompanisë projektuese që përgatitë prezentimin grafik dhe përshkrimi i gjendjes ekzistuese të ndërtimit pa leje		Po	Jo
a. Certifikata e biznesit		☐	☐
b. Informatat e biznesit		☐	☐
Ekipi hartues i projektit të ndërtimit të ndërtimit ekzistues pa leje – përfshihen profesionistët sipas kërkesave të aplikueshme për ndërtimin pa leje			
Arkitekti:		Telefoni:	Emaili:
Inxhinieri i ndërtimit:		Telefoni:	Emaili:
Inxhinieri i hidroteknikes:		Telefoni:	Emaili:
Inxhinieri i makinerisë:		Telefoni:	Emaili:
Inxhinieri i elektrikes:		Telefoni:	Emaili:
Inxhinier i gjeodezisë:		Telefoni:	Emaili:
Personi i licencuar- mbrojtja nga zjarri:		Telefoni:	Emaili:

c. Deklaratë e ekipit hartues	☐	☐
d. Diplomat e ekipit hartues	☐	☐

7. Matja / incizimi dhe përshkrimi i gjendjes ekzistuese të ndërtimit pa leje	Po	Jo	N/A
Vërejtje: Për kërkesat që nuk janë të aplikueshme, zgjidhni opsionin N/A. a. Përshkrimi teknik: dimensionet e ndërtimit, sipërfaqja bruto, etazhiteti, lartësia e kateve, lartësia e ndërtimit, konstruksioni, funksioni, viti i ndërtimit. Vërejtje: Te ndërhyrjet pa leje të jepet edhe ndërlydhja/impakti në ndërtimin me leje	☐	☐	☐
b. Matjet gjeodezike sipas Kornizës së Punës për matje, krijim dhe regjistrim të njësive kadastrale, të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, në lidhje me trajtimin e ndërtimeve pa leje. Vërejtje: te ndërhyrjet pa leje në ndërtimet me leje, incizimi bëhet për pjesën e ndërhyrjes	☐	☐	☐
c. Fotografitë që prezantojnë dukjet e ndërtimit pa leje (të gjitha fasadat) Vërejtje: Te ndërhyrjet, fotografitë duhet të prezantojnë ndërtesën dhe ndërhyrjen pa leje si dhe ndërhyrjen pa leje si të veçantë	☐	☐	☐
d. Raporti i stabilitetit të strukturës duke përfshirë konkludimin e profesionistit për sigurinë dhe stabilitetin e ndërtimit (te ndërhyrjet pa leje të jepet raporti mbi strukturën e ndërhyrjes pa leje dhe ndikimet në strukturën e ndërtimit me leje)	☐	☐	☐
e. Raporti i instalimeve të ujit dhe kanalizimit, duke përfshirë konkludimin e profesionistit nëse janë plotësuar kërkesat themelore për shëndet dhe siguri . (te ndërhyrjet pa leje të jepet raporti mbi instalimet e ndërhyrjes pa leje dhe ndikimet në instalimet e ndërtimit me leje)	☐	☐	☐
f. Raporti i instalimeve elektrike duke përfshirë konkludimin e profesionistit nëse janë plotësuar kërkesat themelore për shëndet dhe siguri. (te ndërhyrjet pa leje të jepet raporti mbi instalimet e ndërhyrjes pa leje dhe ndikimet në instalimet e ndërtimit me leje)	☐	☐	☐
g. Raporti i instalimeve makinerike duke përfshirë konkludimin e profesionistit nëse janë plotësuar kërkesat themelore për shëndet dhe siguri. (te ndërhyrjet pa leje të jepet raporti mbi instalimet e ndërhyrjes pa leje dhe ndikimet në instalimet e ndërtimit me leje)	☐	☐	☐

h. Raporti i mbrojtjes nga zjarri duke përfshirë konkludimin e profesionistit nëse janë plotësuar kërkesat themelore për shëndet dhe siguri. (te ndërhyrjet pa leje të jepet raporti mbi pjesën e ndërhyrjes pa leje dhe ndikimet në pjesën e ndërtimit që është me leje)	☐	☐	☐
--	--------------------------	--------------------------	--------------------------

Sqarim:

Raportet për secilën fazë të ndërtimit (pikat d, e, f, g, h të prezentuara më sipër) duhet të përgatiten nga inxhinierët e fushave përkatëse, përkatësisht personat e licencuar për mbrojtje nga zjarri, që janë përgjegjës për paraqitjen e gjendjes ekzistuese të strukturës së ndërtimit dhe të instalimeve/sistemeve të ndërtimit pa leje.

Raportet për secilën fazë të ndërtimit duhet të përmbajë konkludimin profesional nëse struktura dhe instalimet/sistemet e ndërtimit pa leje i plotësojnë kërkesat themelore për shëndetit dhe siguri.

Nëse personat përgjegjës sipas paragrafit të parë të këtij sqarimi e konsiderojnë të nevojshme, raportet mund të plotësohen me shqyrtime, analiza apo dëshmi tjera.

8. Deklarata e aplikuesit	
Aplikoj për certifikatën e legalizimit të ndërtimit, sipas përshkrimeve në këtë formular dhe në dokumentet përcjellëse, prezentimet grafike dhe informatat shtesë. Konfirmoj se të gjitha faktet të deklaruara në këtë aplikacion janë të vërteta dhe të sakta.	
Nënshkrimi i aplikuesit:	Data (DD/MM/VVVV):
Nënshkrimi i Zyrtarit kompetent:	Data (DD/MM/VVVV):
Vërejtje: Para aplikimit për legalizim duhet të lexohet Ligji Nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe ky Udhëzim Administrativ për tu informua për dokumentet e nevojshme për aplikim, apo të kërkoj sqarime në Komunë. *** Ju lutemi kërkon nga Zyrtari/ja fletë-dëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura ***	

¹ Rubrika “Nuk Aplikohet” (N/A) plotësohet në rastet kur ofruesit e shërbimeve publike nuk ofrojnë shërbime në ato vendbanime si dhe në rastet kur ndonjë kërkesë nuk përkon me llojin e ndërtimit.

Shtojca 2A - Formulari standard i aplikimit për leje të legalizimit për përfundim të ndërtimit për kategorinë II (jo shtëpitë)



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosova

Komuna / Opština / Municipality

Llogo e
Komunës

Kategorizimi i ndërtimeve bëhet sipas Udhëzimit Administrativ të MMPH, nr. 04/2017 për Kategorizimin e Ndërtimeve, shtojcat 1 dhe 2

Për plotësim në zyrë (nga Komuna)	
Numri i Referencës:	
Data e pranimit:	

Vërejtje: Kategorizimi i ndërtimeve të papërfunduara pa leje bëhet në bazë të sipërfaqes dhe veçorive tjera ekzistuese dhe atyre të planifikuara për përfundimin e ndërtimit.

1. Informatat rreth Aplikuesit		A është aplikuesi i autorizuar? Jo ☐ Po ☐	
		Nëse po, aplikimit i bashkëngjitet marrëveshja e noterizuar me pronarin e ndërtimit pa leje	
Emri:		Nr. i ID:	
Adresa:			
Telefoni:		☐	Kontakti përmes telefonit apo përmes e-mailit?
E-maili:		☐	

2. Informatat rreth pronarit të ndërtimit			
Emri:		Nr. i ID:	
Adresa:			

2a. Kopja e letërnjoftimit të aplikuesit	Po	Jo
	☐	☐

3. Detajet rreth ndërtimit ekzistues të papërfunduar			
Adresa e ndërtimit (ose përshkrimi i lokacionit):			
Zona Kadastrale:		Nr. i Parcelës Kadastrale:	
Koordinatat e vendndodhjes GPS:			
Funksioni: Banim me shumë njësi ☐ Konvikte apo ngjashëm ☐ Hotele apo ngjashëm ☐ Afarizëm dhe administratë ☐ Industri, depo ☐ Art, kulturë, argëtim ☐ Arsim, shkencë ☐ Shëndetësi ☐ Sport, rekreacion ☐ Bujqësi ☐ Tjetër: _____			
<u>Viti i ndërtimit</u>			
<u>Plotësoni nën A, ose nën B, ose nën C</u>			
A) Ndërtim pa leje ndërtimore Sipërfaqja bruto e ndërtimit: _____ m ² Numri i kateve të ndërtimit: _____ 	B) Ndërtim në kundërshtim me lejen ndërtimore: <u>Ndryshim në numrin e kateve në krahasim me numrin e lejuar të kateve sipas lejes së ndërtimit</u> ☐ <u>Ndryshim të shputës së ndërtesës në krahasim me shputën e lejuar sipas lejes së ndërtimit</u> ☐ Ndryshim në brendi dhe/apo ndryshim i përdorimit/destinimit në raport me specifikimet e dhëna në leje të ndërtimit ☐ Tjetër: _____ Sipërfaqja bruto e tërë ndërtimit: _____ m ² Numri i të gjitha kateve të ndërtimit: _____	C) Ndërhyrje pa leje: Mbindërtim ☐ Zgjerim ☐ Ndërhyrje pa leje në brendi të ndërtesës dhe/apo ndryshim pa leje i përdorimit/destinimit ☐ Sipërfaqja bruto ndërhyrjes: _____ m ² Numri i kateve të ndërhyrjes: _____ 	

3A. Dëshmitë se aplikuesi është përfitues i skemës së ndihmës sociale në Kosovë janë bashkangjitur	Po	Jo
	☐	☐

Dokumentet në vijim, përveç pikës 7, dorëzohen në një (1) origjinal dhe dy (2) kopje.

Dokumentet në pikën 7 dorëzohen në tri (3) kopje fizike dhe një (1) kopje digjitale - pjesët grafike në format PDF dhe DWG.

4. Dëshmitë mbi ndërtimin e filluar para datës 05.09.2018:	Po	Jo	N/A ⁱ
a. Ortofoto zyrtare ose fotografi tjera ajrore apo satelitore të realizuara para datës 05.09.2018, në të cilën shihet ndërtimi.	☐	☐	☐
Nëse ekzistimi i ndërtimit nuk mund të vërtetohet sipas pikës a, aplikuesi jep një deklaratë nën betim lidhur me kohën kur është ndërtuar ndërtimi (pika b.), si dhe një nga dëshmitë të listuara nën pikat c, d, ose e.			
b. Deklaratë nën betim lidhur me kohën kur është ndërtuar ndërtimi	☐	☐	☐
c. Prova të pagesës së tatimit në pronë	☐	☐	☐
d. Prova të pagesës së faturave të shërbimeve publike	☐	☐	☐
e. dokument të lëshuar nga një autoritet publik	☐	☐	☐
Në rast të mungesës së dëshmive nën pikat c, d, ose e, aplikuesi sjellë dy nga dëshmitë nën pikat f, g, h.			
f. fatura të ndërlidhura për ndërtimin	☐	☐	☐
g. kontratë të ndërlidhur për ndërtimin	☐	☐	☐
h. dokument tjetër të besueshëm që dëshmon kohën kur është ndërtuar ndërtimi	☐	☐	☐

5. Dëshmitë mbi të drejtën pronësore ose të drejtën e shfrytëzimit mbi parcelën:	Po	Jo	N/A ⁱ
Kopja e planit dhe certifikata e pronësisë jo më të vjetra se gjashtë muaj. Nëse pronari i ndërtimit pa leje nuk është pronari i regjistruar i parcelës, dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm për të dëshmuar të drejtën pronësore ose të drejtën e shfrytëzimit mbi parcelën.	☐	☐	☐

6. Dokumentacioni i kompanisë projektuese që përgatitë prezentimin grafik dhe përshkrimi i gjendjes ekzistuese të ndërtimit pa leje të përfunduar				Po	Jo
a. Certifikata e biznesit				☐	☐
b. Informatat e biznesit				☐	☐
Ekipi hartues i projektit të ndërtimit të ndërtimit ekzistues pa leje – përfshihen profesionistët sipas kërkesave të aplikueshme për ndërtimin pa leje					
Arkitekti:		Telefoni:	Emaili:		
Inxhinieri i ndërtimit:		Telefoni:	Emaili:		
Inxhinier i gjeodezisë:		Telefoni:	Emaili:		
Personi i licencuar- mbrojtja nga zjarri:		Telefoni:	Emaili:		
c. Deklaratë e ekipit hartues				☐	☐
d. Diplomat e ekipit hartues				☐	☐

7. Matja / incizimi dhe përshkrimi i gjendjes ekzistuese të ndërtimit pa leje të papërfunduar	Po	Jo	N/A ⁱ
